



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:061011

Datë: 26.05.2021

Numri i dokumentit: 01817571

AA.nr.292/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit S.B., nga fshati ..., Komuna e Fushë Kosovës, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1221/2017 të datës 05.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.05.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit S.B., nga fshati, Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1221/2017 i datës 05.01.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1221/2017 të datës 05.01.2021, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit S.B., nga fshati, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i datës 17.05.2016, i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi S.B. përmes Ndhmës Juridike falas, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që e njëjta të aprovohet, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe paditësit ti njihet e drejta apo ti aprovohet kompensimi për personat e verbër për vitet 2013 deri në vitin 2016, ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 194 të

Ligjit të Procedurës Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, me vendimin e datës 17.05.2016, e ka refuzuar ankesën e z/znj SS.B., me numër të ID-së:, në kompensim për personat e verbër, për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 21.07.2017, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Andaj, gjykata e shkallës së parë nuk i aprovoi pretendimet e paditësit, sepse i vlerësoi si të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga ana e organeve administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-092 për Persona të Verbër, me të cilët në par. 3, 4, 5 dhe 6 përcaktohet se “3. *Personat e verbër, përfitues nga ky ligj i nënshtrohen vlerësimit të komisionit Mediko-social në ministrinë dhe rajonet përkatëse.* 4. *Komisioni Mediko-social për personin e verbër lëshon vendim, duke përcaktuar grupin e verbërisë, si dhe nevojat sociale.* 5. *Komisioni shqyrton kërkesën e personit të verbër, për të përcaktuar shkallën e verbërisë dhe nevojave sociale.* 6. *Përfituesit nga ky ligj kategorizohen në dy grupe: 6.1. grupi i parë janë personat që nuk e dallojnë dritën nga errësira, deri në qartësinë e të parit 0.02. 6.2. grupi i dytë janë personat që kanë humbje pjesërisht të shikimit, mbi 0.02 deri 0.05”.* Andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore, në bazë të të cilave është refuzuar kërkesa e paditësit për njohjen e të drejtës në pension të personave të verbër në kategorinë e parë.

Përkundër se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të

thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka vërtetuar vendimin e të paditurës MPMS - DP, duke i bërë gabimet e njëjta, dhe duke bërë shkelje të dispozitave ligjore, saktësisht të nenit 17 par.6 pika 6.2 të Ligjit Nr.04/L-092 për Persona të Verbër, lidhur me kompensimin për personat e verbër, pasi që paditësi e ka humbur shikimin shumë vite më parë, dhe që nga viti 2013 i ka takuar ky kompensim, e po ashtu duke pasur parasysh faktin se i njëjti është përfitues i këtij pensioni që nga viti 2016. Këto pretendime ankimore sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate nuk qëndrojnë, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë. Ngase gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk i ka aprovuar pretendimet e paditësit se organi i paditur nuk i ka arsyetuar veprimet e veta, dhe nuk ka dhënë sqarime sa i përket kërkesës për kthimin e mjeteve që nga viti 2013 në mënyrë retroaktive. Ngase Komisioni Mjekësor i ekspertëve ka sqaruar edhe gjatë seancës gjyqësore se paditësi në këtë periudhë nuk ka bërë pjesë në grupin e parë të verbërve, dhe se i njëjti me asnjë provë nuk ka dëshmuar pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nga paditësi se i njëjti ka vizituar mjekë specialist të lëmive përkatëse, nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative juridike, ngase për t'iu njohur kjo e drejtë i njëjti duhet të ofrojë dëshmi të mjaftueshme se i përmbush kriteret e parashikuara me Ligjin nr.04/L-092 për Persona të Verbër. Prandaj, nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Sepse sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të kontestuar, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.292/2021 me datë 17.05.2021

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi